



STATUTI
I
UNIVERSITETIT TË ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"

Elbasan, Maj 2012

KREUI **PARIME TE PERGJITHSHME**

Neni 1

Parimet themelore

1. Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani" (UE), ne perputhje me parimet e Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe Magna Charta te Universiteteve eshte institucion publik, autonom, laik, kerkimor-shkencor dhe didaktik i arsimit te lartë.
2. Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani" (UE) eshte person juridik publik, i njohur si i tille me ligjin nr.9741 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), neni 4, pika 2.
3. Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani" (UE) eshte krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.414, dt.12.11.1991, duke ruajtuar me krenari origjinen e Institutit te Lartë Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani" (ILP) themeluar më 1971, i cili u pervijua si vazhdues i drejtpërdrejtë i Shkollës Normale të Elbasanit (i pari institucion kombëtar i përgatitjes së mësuesve ne Shqiperi themeluar më 1909).
4. Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr.9741 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në këtë Statut si dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të Statutit.
5. Selia ligjore e Universitetit te Elbasanit "A.Xhuvani" eshte Rektorati me adresë: Rruga "Rinia" Elbasan. Ndërsa, njësitë e tjera fikse të Universitetit kanë selitë e tyre persa percaktuar në rregulloret respektive.
6. Universiteti i Elbasanit "A. Xhuvani" (UE) ka stemën dhe vulën e tij te cilat janë sipas anekseve bashkëlidhur këtij Statuti.

Neni 2

Misioni

1. Universiteti i Elbasanit "A. Xhuvani" (UE) eshte një institucion publik, autonom, laik, kerkimor shkencor dhe didaktik i arsimit të lartë që ka për detyrë parësore kerkimin shkencor dhe didaktiken, aktivitete te drejtuara per te ndjekur nje dituri kritike te hapur ne lidhjen midis kulturave, ne respektim te lirise se shkences dhe mesimit.
2. Universiteti njeh barazi dhe mundesi te barabarta per te gjitha disiplinat qe garantojne pasurine shkencore dhe formuese.
3. Universiteti mbron dhe rinovon pasurine e tij kulturore duke ju pergjigjur pretendimeve te ndryshme te shprehuara nga shoqeria.
4. Detyrimi i Universitetit te Elbasanit "A. Xhuvani", vendi i dijes dhe i diturive, eshte te interpretoje dhe te orientoje transformimet pikerisht te kohes, duke garantuar perpunimin, inovacionin, transferimin dhe vleresimin e njohurive ne avantazh te individeve dhe te shoqerise.
5. UE ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës, për çdo tipologji te formimit të nivelit të lartë, përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë dhe/apo plotësuese për to, si dhe kërkimin shkencor për ceshtjet me interes publik dhe/apo privat.
6. UE eshte i angazhuar që, në fushat e kërkimit shkencor dhe të didaktikës, të garantojë sistemin e cilësisë sipas standardeve evropiane.
7. UE ndërmerr çdo iniciativë, per aq sa legjitimohet sipas Kushtetues dhe normativeve perkatese ne fuqi, derisa e drejta e studimit të thelluar të studentit të jetë përmbushur si dhe u garanton atyre realizimin e objektivave kulturore dhe profesionale.
8. UE u garanton punonjësve akademikë mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet për kërkimin shkencor.
9. UE promovon dhe nxit dimensionin ndërkombëtar të studimeve, të mësuarit dhe të

kërkimit shkencor. UE konsideron si një nga detyrat e tij themelore edhe zhvillimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të pedagogëve dhe të studentëve si dhe pranimin e formimit të studentëve të huaj.

10. UE ndjek qëllimet e tij në përputhje të plotë me dinjitetin human, ne pluralizmin e ideve dhe ne transparencën e procedurave. I garanton çdo pedagogu autonominë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij Statuti, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me të drejtën e studimit dhe me pozitën juridike përkatëse.
11. UE promovon, organizon dhe kryen shërbime formuese dhe kulturore në territorin e qarkut të Elbasanit, në të gjithë vendin, si dhe jashtë tij.
12. UE organizon brenda tij vlerësimin e arritjes së qëllimeve të tij institucionale.
13. UE vendos dhe favorizon drejtimin didaktik si dhe kërkimin shkencor të studentëve sipas nevojave formuese të tyre.
14. UE garanton shprehjen e lirë të ideve akademike, i krijon kushte personelit dhe studentëve për shprehjen dhe promovimin e lirë të mendimeve të tyre si dhe u siguron mundësi të barabarta për punë dhe studim.

Neni 3

Parimet organizative

1. UE ka autonomi dhe liri akademike cila shprehet ne:
 - a. Zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve drejtuese te tij.
 - b. Organizimin e strukturave të tij të brendshme dhe veprimtarinë e tyre në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, statutin dhe rregulloret e hartuara në zbatim të tyre.
 - c. Në përcaktimin e fushave të didaktikes dhe të kërkimit shkencor.
 - d. Të drejtën për hartimin e programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit shkencor.
 - e. Në përzgjedhjen e personelit të tij akademik e administrativ.
 - f. Të drejtën e caktimit të kriterëve të veçanta të pranimit të studentëve.
 - g. Të drejtën për të lidhur marrëveshje me Universitete e shkolla të larta nacionale dhe te huaja si me institucione të tjera të tjera për shkëmbim përvoje, trajnime, kualifikimin e personelit ose për kërkime shkencore në fusha me interes të përbashkët.
 - h. Të drejtën e anëtarësimit në shoqata kombëtare apo ndërkombëtare që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë
2. UE ka zotësi të plotë për të vepruar si subjekt i së drejtës publike dhe/ose private në qarkullimin civil, vetëm në përmbushje të misionit të tij, si dhe në ushtrimin e kompetencave përkatëse.
3. UE favorizon e garanton, diskutimin dhe shkëmbimin e mendimit të lirë për problemet që lidhen me përmbushjen e qëllimeve të universitetit. Gjithashtu garanton publikimin e propozimeve të akteve që shqyrtojnë organet e tij, me përjashtim të atyre propozimeve që kanë karakter thellësisht privat apo personal. Publikimi kryhet me anë të shpalljes apo shpërndarjes së projekt-akteve, si dhe me njoftimin e mëpastajshëm të akteve të miratuara nga organet kolegjiale përkatëse.
4. UE është njësi ekonomike autonome qe ka te drejtën për te mbledhur fonde dhe për te përfituar mjete materiale, sipas rregullave ne fuqi, si dhe te drejtën për te realizuar marrëveshje te pavarura me Qeverinë ose me organizma të tjerë nacionale dhe/ose nderkombetare për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore; te drejtën për te realizuar marrëveshje me institucione, shoqëri tregtare ose organizata te tjera jo fitimprurese, vendase ose te huaja, publike ose private; te drejtën për te administruar fonde publike e te ardhura te tjera qe disponohen sipas mënyrës se përshkruar ne ligj.
5. UE vlerëson mënyrën e përdorimit të buxhetit të shpenzuar nga njësitë e tij në përmbushjen e detyrave përkatëse, me qëllim ekonomizimin dhe efikasitetin e

drejtimit të Universitetit, si dhe përpunon e shpall indikatorët për të verifikuar objektivat e vendosura, rezultatet e arritura dhe kostot përkatëse.

6. Bilancet e Universitetit dhe të njëjve të tij që kanë autonomi të brendshme financiare bëhen publike 30 ditë pas aprovimit nga organi përkatës.
7. UE vendos lirisht për të kërkuar konsulencën e avokatëve të regjistruar në Dhomën Kombëtare të Avokatëve si dhe te profesionistëve të lire të licencuar nga organet përkatëse sipas formsë dhe mënyrës së parashikuar shprehimisht në ligj.

Neni 4

Programimi i veprimtarisë

1. UE e zhvillon veprimtarinë e tij institucionale brenda sistemit universitar publik kombëtar dhe rajonal me të cilët bashkëpunon dhe vetërregullon marrëdhëniet me qëllim përmbushjen e objektiveve të tij.
2. UE në përputhje me objektivat e tij të politikës kulturore, kërkimit, mësimdhënies dhe në respektimin e lirisë të secilit, harton programe dhe projekte kërkimore shkencore specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurrin me këto projekte si në planin kombëtar dhe nderkombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor.

KREU II

ORGANIZIMI I BRENDSDHEM

Neni 5

Njësitë përbërëse

1. Universiteti i Elbasanit përbëhet nga njësi organizative kryesore, njësi bazë dhe njësi ndihmëse.
2. Njësitë organizative kryesore janë:
 - a. Fakultetet
3. Njësitë organizative bazë janë:
 - a. Departamentet;
 - b. Qendrat kërkimore-shkencore
4. Njësi ndihmëse janë:
 - a. Laboratorët;
 - b. Qendra e medias, informimit dhe e këshillimit të studentëve
5. Njësi administrative janë:
 - a. Drejtoria e Standarteve dhe e Kurrikulave
 - b. Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë
 - c. Drejtoria e burimeve njerëzore, Informacionit dhe Arkivës
 - d. Drejtoria Ekonomike
 - e. Drejtoria Juridike
 - f. Drejtoria e bibliotekave
 - g. Sektori i botimeve
6. **Secila nga këto njësi ka strukturën e saj**, si dhe ka autonomi normuese (në nxjerrjen e akteve të veta normative), vetëveprimi dhe financiare, sipas përcaktimeve në këtë Statut dhe në rregulloren e UE.

Neni 6

Fakultetet

1. Fakulteti është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.

2. UE pwr bwet nga kwto Njwsi Kryesore:
 - FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES
 - FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
 - FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT
 - FAKULTETI EKONOMIK
 - FAKULTETI I INFERMIERISE
3. Fakulteti organizohet në njësi bazë (Departamentet).
4. Njësitë bazë (departamentet), me emërtimet përkatëse, të një fakulteti përcaktohen në rregulloren e UE-sw, që miratohet në zbatim të këtij statuti. Fusha specifike e secilës njësi bazë përcaktohet në rregulloren e fakultetit.
5. Organet kolegjiale dhe monokratike ne fakultet janë: këshilli i fakultetit, dekani, zëvendësdekanët, mbrojtësi i studentëve, këshilli i profesorëve.
6. Mbrojtësi i studentëve caktohet një prej pedagogëve të fakultetit, i cili emërohet nga dekani, pas miratimit paraprak të kandidaturës së tij nga studentët, që shprehet nga përfaqësuesi i studentëve në këshillin e fakultetit. Mbrojtësi i studentëve ka mandat 4 - vjeçar dhe ka për mision përcjelljen e çdo problemi të studentëve tek dekani, këshilli i fakultetit apo kancelari sipas kompetencës së tyre. Nëse organi përkatës në fakultet nuk shprehet për këtë problem, mbrojtësi i studenteve i drejtohet Rektorit të universitetit. Çdo student si verbalisht apo me shkrim, i identifikuar apo në mënyre anonime ka të drejtë të verë në lëvizje mbrojtësin e studentëve i cili detyrohet që të evidentojë në një regjistër, çdo shqetësim dhe zgjidhjen përkatëse që i është dhënë.
7. Secili fakultet miraton rregulloren e tij bazuar në specifikën e fushës që mbulon.

Neni 7

Njësitë organizative bazë

1. **Departamenti** është njësi bazë mësimore-kërkimore në UE që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive.
2. UE ka kwto njwsi bazw:
 1. Departamenti i Matematikës
 2. Departamenti i Fizikës
 3. Departamenti i Biologjisë
 4. Departamenti i Kimisë
 5. Departamenti i infermieristikws
 6. Departamenti i lwndwve klinike dhe paraklinike
 7. Departamenti i gjuhës shqipe
 8. Departamenti i letërsisë dhe gazetarisë
 9. Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë
 10. Departamenti i gjuhëve angleze dhe gjermane
 11. Departamenti i gjuhëve italiane dhe franceze
 12. Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies
 13. Departamenti i Psikologjisë
 14. Departamenti i Shkencave sociale
 15. Departamenti i Edukimit Qytetar
 16. Departamenti i Administrim-Biznesit
 17. Departamenti i Financë-Kontabilitetit
 18. Departamenti i Ekonomisë dhe sw drejtw
3. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.
4. “Departamenti organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor. Titullarët e grupeve duhet të kenë, së paku, gradën shkencore “Doktor”

Formatted: Font: Times New Roman, Not

Formatted: Indent: Left: 0.25"

Formatted: Font: Times New Roman, Not

Formatted: Font: Times New Roman, Not

Formatted: Font: Times New Roman, Not

dhe përzgjidhen me konkurrim të hapur, të drejtuar nga një komision ad hoc, i ngritur nga Këshilli i Profesorëve. Procedurat e ngritjes së komisionit ad hoc dhe të konkurrimit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Titullari i njësisë bazë i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni ad hoc, për një periudhë 4-vjeçare.

5. Fusha e kërkimit shkencor, disiplinat mësimore dhe struktura organizative e secilit departament përcaktohen në rregulloren e fakultetit.
6. **Qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit** janë njësi bazë të kërkimit dhe zhvillimit në UE, fushat e kërkimit të cilave harmonizohen me interesat e departamenteve të fakultetit. Ato përfshijnë fusha kërkimi homogjene.
7. Qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë me karakter kërkimor shkencor në fushat që ata mbulojnë si dhe marrin pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë.
8. Struktura e qendrave të kërkimit dhe të zhvillimit është e njejte me atë të departamentit.
9. Pozita juridike e përgjegjësit të departamentit, marrëdhëniet e tij me pedagogët e departamentit, me organet e tjera në fakultet, si dhe me të tretët, përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Neni 8

Njësitë ndihmëse

1. **Laboratorët** janë njësi ndihmëse të procesit mësimor dhe atij kërkimor. Me veprimtarinë e tyre të udhëhequr nga personeli akademik, ndihmojnë në formimin shkencor e metodik të studentëve. Ata varen nga departamenti, qendra ose fakulteti përkatës dhe funksionojnë me rregullore të Fakultetit.
2. **Biblioteka** e UE është njësi ndihmëse e cila mbështet punën mësimore e atë kërkimor shkencore . Ajo është në shërbim të të gjithë studentëve dhe të personelit akademik e atij joakademik.
3. **Qendra e teknikës mësimore dhe e trajnimit profesional** është një qendër që ndihmon drejtpërdrejt zhvillimin e procesit mësimor dhe ndihmon në procese të trajnimit profesional në UE.
4. **Qendra e medias e informimit dhe e këshillimit të studentëve** është në shërbim të studentëve për plotësimin e nevojave të tyre për informim në rrugë elektronike mbi të rejat e shkencës që ato studiojnë dhe për mundësitë që ofrojnë institucionet e huaja për studim.
5. Drejtuesit e bibliotekës dhe qendrave emërohen nga Rektori duke u bazuar në Rregulloren për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës.
6. Funksionimi dhe administrimi i njësisve ndihmëse përcaktohet në rregullore të veçantë.

Neni 9

Njësitë administrative

1. **Drejtorja e Kurrikulave dhe Standarteve** ndjek të gjitha problemet e fushës akademike e shkencore në UE. Ajo përbëhet nga specialistë që kanë eksperiencë pune mësimore e shkencore në shkollën e lartë, njëri nga të cilët emërohet kryetar.
2. **Drejtorja Marrëdhënieve me Jashtë** ndjek të gjitha marrëdhëniet me Universitetet e huaja, zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me to dhe projektet ndërkombëtare në të cilat UE merr pjesë. Ajo përbëhet nga specialistë që kanë eksperiencë pune mësimore e shkencore në shkollën e lartë, janë njohës të mirë të gjuhëve të huaja (e domosdoshme gjuha angleze), njëri nga të cilët emërohet kryetar.
3. **Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit**, nën drejtimin e Rektorit, ndjek procedurat e marrjes e trajtimit të personelit pedagog (e të tjerë sipas Statutit) në Universitetin e Elbasanit, për zbatimin në këto procese të akteve ligjore e nënligjore, të Statutit të Universitetit, urdhrave e udhëzimeve të Ministrisë Arsimit dhe Shkencës,

vendimeve të Senatit e urdhrave të Rektorit, mban të dhënat e veprimtarisë për secilin, ndjek skemën e organizimit institucional e akademik të Universitetit.

4. **Drejtoria Juridike** siguron ndihmen juridike për veprimtarinë dhe aktet e njesive kryesore, baze, në Universitet, Rektorit, Kancelarit dhe administratës, si dhe shfaq mendime për projektet që i dërgohen Rektorit nga institucionet qendrore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore; përfaqëson Universitetin në proceset gjyqësore.
5. **Drejtoria Ekonomike**, ndjek zbatimin e gjithë procedurave financiare të realizimit të buxhetit të Universitetit, të buxheteve të tjera (shërbime, donacione, projekte), mbajtjen e dokumentacionit përkatës në lidhje të ngushtë me organizmat financiarë shtetërorë, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore.
6. **Qendra e medias e informimit dhe e këshillimit të studentëve** organizon të gjitha publikimet me karakter shkencor, inovues dhe shpërndares të UE, përgjigjet për të gjitha ceremonitë e organizuara nga UE, mban lidhje me të gjitha institucionet kulturore, artistike e botuese në rreth e më gjerë. Qendra drejtohet nga përgjegjësi i saj.
7. Drejtuesit e njësive të mësipërme emërohen nga Rektori duke u bazuar në Rregulloren për zënieën dhe ruajtjen e vendit të punës

Neni 10

Filialet

Filiali hapet me vendim të Senatit akademik. Filiali është njësi e veçantë e UE që hapet me vendim të Këshillit të Ministrave si njësi kryesore dhe me vendim të Senatit Akademik si njësi bazë ose njësi ndihmëse.

1. Kriteret minimale për t'u hapur një filial janë:
 - a) të plotësojë standardet akademike në lidhje me kualifikimin e pedagogëve;
 - b) të ketë një infrastrukturë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për shërbimin që do të ofrohet;
 - c) të ketë fonde të mjaftueshme buxhetore për të përballuar kostot përkatëse.
2. Mënyra e funksionimit të filialit në raport me Universitetin dhe fakultetin përkatës parashikohet në rregulloren e UE-së.

KREU III

ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE

A. ORGANET DREJTUESE

Neni 11

Organet drejtuese dhe administruese të UE-së

1. Organe drejtuese dhe administruese të UE-së janë:
 - a. Senati akademik;
 - b. Rektorati;
 - c. Këshilli i administrimit;
 - d. Këshilli i Fakultetit;
 - e. Këshilli i etikës
2. Organe të tjera kolegjiale janë :
 - a. Këshilli i profesorëve
3. UE ka të drejtë të propozojë pranë strukturave përkatëse edhe formimin e organeve të reja drejtuese në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij.

Neni 12

Senati akademik

1. Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës i UE-së, i cili përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e didaktikes e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
2. Kryetar i Senatit akademik është Rektori.
3. Senati akademik mbledhet periodikisht, si rregull 1 herë në muaj.
4. Senati akademik përbëhet nga nga Rektori dhe përfaqësues të zgjedhur me votim të fshehtë nga personeli akademik, personeli joakademik dhe nga studentët, të zgjedhur sipas procedurave të përcaktuara në *“Rregulloren e zgjedhjeve të UE”*.
5. Senati akademik ka këto funksione kryesore :
 - a. garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe të mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit shkencor, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b. miraton planin disaveçar të zhvillimit të UE dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - c. vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projekt-buxhetin e UE, pasi merr miratimin nga Këshilli i administrimit;
 - d. miraton ndarjen e burimeve financiare;
 - e. miraton projektstatutin e UE me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
 - f. vlerëson hapjen apo mbylljen e programeve të reja të studimit në UE, të kërkimit dhe të zhvillimit, apo pjesë të tyre, të cilat me pas ia dergon MASH për miratimin e tyre.
 - g. vlerëson dhe miraton hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore - shkencore;
 - h. miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore, si dhe atë financiar, në një mbledhje të hapur për të gjithë personelin akademik e administrativ dhe për studentët.
 - i. vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UE, në përputhje me standardet shtetërore;
 - j. vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
 - k. siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e arsimit të lartë, duke garantuar cilësinë dhe transparencën e duhur;
 - l. kërkon mendimin e Këshillit të administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit. I propozon MASH kuotat dhe kriteret të veçanta të pranimeve në UE, si dhe tarifat e regjistrimit dhe të studimeve;
 - m. përcakton kriteret e pranimit për kandidatë në ciklin e dytë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve, si dhe i propozon MASH kuotat përkatëse;
 - n. miraton në parim marrëveshjet apo kontratat e bashkëpunimit me të tretët, që do të nënshkruajë Rektori, në emër dhe për llogari të UE-së;
 - o. miraton paraprakisht hapjen e filialeve, krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekteve të tjera të shërbimit që ofrohen nga fakultetet, bazuar në propozimin e Këshillit të fakultetit përkatës;
 - p. miraton rregulloren e brendshme të tij;
 - q. miraton rregulloret e UE-së që janë kompetencë e tij.
6. Nga anëtarët e tij Senati akademik zgjedh nënkryetarin dhe sekretarin e tij, statusi i të cilëve përcaktohet në rregulloren e brendshme të Senatit akademik.
7. Senati akademik i UE organizohet në komisione të përhershme:
 - a. Komisioni i punës mësimore
 - b. Komisioni i punës kërkimore shkencore
 - c. Komisioni politikave të zhvillimit e akreditimit
 - d. Komisioni i buxhetit dhe investimeve
 - e. Komisioni i marrëdhënieve me jashtë
8. Mandati i senatit është 4 – vjeçar.
9. Mandati i anëtarit të senatit merr fund kur :

- përmbushet afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - largohet nga UE;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin;
 - nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit akademik.
 - kur denohet me vendim gjyqësor të formës së prera.
- Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas “Rregullores së zgjedhjeve”.
10. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Senatit akademik, pjesëmarrja, votimi, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështje të tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e brendshme të Senatit akademik të UE.

Neni 13

Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv, që përbëhet nga:
 - a. rektori;
 - b. zëvendësrektori/ët;
 - c. dekanët;
 - d. kancelari.
2. Rektorati kryesohet nga Rektori
3. Funksionet kryesore të Rektoratit janë:
 - a. hartimi i planit disavjeçar të zhvillimit të UE;
 - b. hartimi i programit vjetor të veprimtarive dhe ndjekja e zbatimit të tij pas miratimit në Senatit akademik;
 - c. formulimi i kriterëve për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - d. parashtrimi i përparësive mes kërkesave konkurruese për financime nga njësitë kryesore të UE-së;
 - e. hartimi dhe propozimi për miratim në Senatit akademik i projektbuxhetit të UE-së;
 - f. hartimi i planit të investimeve, i kontratave dhe i marrëveshjeve, që janë kompetencë e tij;
 - g. paraqitja e rekomandimeve për projektet e programeve të studimit, të kërkimit shkencor dhe të ndryshimeve të nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - h. zbatimi i të gjitha vendimeve të miratuara nga Senati akademik dhe Këshilli i administrimit;
 - i. monitorimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit të veprimtarive të UE;
 - j. përgatitja e marrëveshjes për rregullat e financimit ndërmjet UE dhe Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës;
 - k. propozimi i strukturës së përgjithshme dhe i numrit të personelit të UE për të gjitha nivelet;
 - l. përgatitja e rregullores së tij të brendshme e cila miratohet nga Senati akademik.
 - m. ushtrimi i kontrolleve tematike në njësitë e UE-së lidhur me ndjekjen dhe zbatimin e procedurave për pranimet (regjistrimet) e reja, për hartimin dhe zbatimin e strukturas së njësive kryesore të vitit akademik, për zbatimin dhe realizimin e planeve dhe programeve mesimore, për plotësimin e dokumentacionit që duhet të ketë çdo njësi kryesore dhe njësi baze, etj., për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të Universitetit.

4. Rektorati kërkon mendimin e Senatit akademik dhe të Këshillit të administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit.
5. Rektorati raporton një herë në semestër në Senatin akademik dhe në Këshillin e administrimit për aspekte që janë në kompetencë të këtyre të fundit.
6. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe ia paraqet atë për miratim Senatit akademik brenda muajit shtator të çdo viti.
7. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore - shkencore dhe ia paraqet atë për miratim Senatit akademik brenda muajit dhjetor të çdo viti.
8. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë financiare dhe ia paraqet atë për miratim Këshillit të administrimit brenda muajit dhjetor të çdo viti.
9. Rektorati ofron infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e funksionimit të organeve dhe autoriteteve drejtuese të Universitetit .

Neni 14

Këshilli i administrimit

1. Këshilli i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë e UE-së, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.
2. Funksionet kryesore të Këshillit të administrimit janë:
 - a. miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
 - b. miraton me kërkesën e Senatit akademik projektbuxhetin e UE-së me dy të tretat e votave;
 - c. vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;
 - d. miraton strukturën dhe numrin e personelit të UE-së për të gjitha nivelet;
 - e. miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga Rektorati;
 - f. vlerëson planin e zhvillimit të UE-së dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - g. miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
 - h. miraton rregulloren e brendshme të tij;
 - i. i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratim tarifen e regjistrimit.
 - j. i propozon MASH kriteret për përcaktimin e nivelit të pagave të punonjësve mësimorë dhe jo mësimorë, si dhe tarifën e orës mësimore;
 - k. informon Senatin akademik për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë Universitetin.
4. Këshilli i administrimit përbëhet nga:
 - a. Një anëtar i brendshëm i personelit akademik, së paku me gradë shkencore, të zgjedhur drejtpërdrejt nga personeli akademik për çdo njësi kryesore të UE;
 - b. anëtarë të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, të ekonomisë, të kulturës, autoritete të pushtetit qendror dhe atij vendor;
 - c. një anëtar, përfaqësues i zgjedhur nga këshilli i studentëve të UE.
5. Anëtarët, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, caktohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës. Numri i anëtarëve të caktuar është një më pak se numri i anëtarëve nga personeli akademik e studenti i zgjedhur të këshillit të administrimit. Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin, prej anëtarëve të brendshëm të personelit akademik të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.
6. Anëtarësia në Këshillin e administrimit është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të Senatit akademik, të zëvendësrektorit/ëve, të dekanëve, të zëvendësdekanëve.
7. Mandati i anëtarit të Këshillit të administrimit mbaron kur:
 - përbushet afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - largohet nga UE, për ata që janë të caktuar sipas pikës 3, shkronjat “a” dhe “c”, të këtij neni;

- bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin;
 - kur nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e Këshillit të administrimit;
 - për ata që janë të emëruar sipas shkronjës b, të pikës 3 (kur lirohen me akt të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës) Ministri duhet të njoftojë Rektoren 15 ditë përpara se emërimi i ri të hyjë në fuqi.
8. Rektori dhe kancelari i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky Këshill.
 9. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit të Administrimit, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Këshillit të administrimit të UE. Mbledhja e parë për konstituimin e Këshillit të Administrimit thirret nga Rektori i UE-së dhe drejtohet nga anëtarë i brendshëm i personelit akademik me moshën më të madhe.
 10. Rektori i UE-së siguron infrastrukturën administrative për zhvillimin e mbledhjeve dhe ruajtjen e dokumentacionit të Këshillit të Administrimit.

Neni 15

Këshilli i fakultetit

1. Këshilli i fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve përdorimin e burimeve njerëzore e materiale në dispozicion të fakultetit.
2. Këshilli i fakultetit kryesohet nga dekani.
3. Këshilli i fakultetit ka këto kompetenca:
 - a. Shqyrton dhe miraton kërkesat e departamentit për programe të reja studimi dhe ia propozon Senatit akademik për veprime të metejshme.
 - b. Ai propozon për programe të reja studimi a të kërkimit shkencor, për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh a njësisish të tjera; merr vendime për problemet financiare të fakultetit, shqyrton e miraton, në një mbledhje të hapur për personelin akademik administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të fakultetit.
 - c. merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij;
 - d. shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore e shkencore;
 - e. i propozon Senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij;
 - f. miraton rregulloren e fakultetit;
 - g. miraton në parim marrëveshjet që synon të lidhë fakulteti i tyre me të tretë, përpara se të nënshkruhen nga dekani, *vetëm pasi të autorizohet për këtë fakt nga rektori.*
4. Në ushtrimin e kompetencave të tij Këshilli i fakultetit shprehet me vendime.
5. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit të fakultetit, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Këshillit të fakultetit.

Neni 16

Këshilli i etikës

1. Këshilli i etikës i UE është organ kolegjal, i cili diskuton për probleme të etikës së jetës universitare. Ai i bën propozime rektorit për këto çështje.
2. Anëtarët e Këshillit të etikës përzgjidhen nga Senati akademik, nga personeli akademik si rregull me titullin apo gradën më të lartë, sipas propozimeve të Rektorit.

3. Këshilli i etikës përbëhet nga 5 anëtarë dhe kryesohet nga Rektori. Këshilli duhet të ketë në përbërjen e tij një jurist.
4. Në mbledhjen e parë të tij, Këshilli i etikës miraton rregulloren e etikës së universitetit.
5. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e etikës të UE -së.
6. Këshilla të etikës mund të ngrihen edhe pranë fakulteteve.

Këshilli i Profesorëve
Neni 17
Përbërja dhe funksionimi

1. Për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës, në njësiti kryesore ngrihet Këshilli i Profesorëve. Këshilli i Profesorëve mund të ngrihet edhe në nivel të universitetit, kur njësitë kryesore nuk përmbushin numrin e nevojshëm të profesorëve me kohë të plotë.
2. Këshilli i profesorëve (KP) është organ kolegjal, i cili përbëhet nga të gjithë pedagogët me kohë të plotë që kanë titullin “Profesor”.
 1. Numri minimal i profesorëve të KP-së duhet të jetë 7 (shtatë).
 2. Në rast se numri i profesorëve të fakultetit është më i vogël se shtatë, për të arritur këtë numër në KP mund të thirren profesorë të fushave të afërta nga fakultetet e tjera brenda UE, profesorë të ftuar apo profesorë me kontratë të fakultetit ose anëtarë me titullin “Prof. Assoc.”, që janë në procesin e aplikimit për titullin “Profesor”.
3. Drejtimi i KP bëhet me rotacion për një vit akademik. Drejtuesi i KP zgjidhet nga i gjithë KP duke siguruar 50%+1 të votave.
4. Funksionimi i KP bëhet sipas rregullores së miratuar prej tij.

Neni 18
Kompetencat e Këshillit të Profesorëve

Kompetencat e KP janë:

1. Jep mendim për kërkesën e kandidatëve që kanë aplikuar për të mbrojtur doktoraturën.
2. Miraton propozimin e departamenteve për hapjen, mbylljen apo riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës.
3. Vëzhgon dhe këshillon veprimtarinë e departamenteve përkatës në procesin e organizimit dhe drejtimit të programeve të studimit të doktoratës.
4. Bazuar edhe në vlerësimin e departamenteve përkatës miraton ose jo autoreferatin e disertacionit të një doktrate.
5. Miraton kandidatin fitues të programit të studimit të doktoratës.
6. Organizon dhe drejton kualifikimin shkencor pedagogjik pas doktoratës.
7. Bën promovimin për titullin “Docent”, “Prof. Assoc.” sipas kërkesave të departamenteve përkatës.
8. Bazuar kryesisht në vlerësimin e departamentit përkatës si edhe në gjykimin e tij për veprimtarinë mësimore e kërkimore të kandidatit i propozon Rektorit/Dekanit, dhënien e titullit “Docent”.
9. Mbështetur në propozimin e departamentit, ngre komisionin e vlerësimit për titullin “Prof.Assoc.”.
10. Jep mendim për dosjet e personave që kanë aplikuar për titullin “Prof. Assoc.” dhe ia përcjell për procedurë të mëtejshme Rektorit.

11. Zyrtarizon vendimin e komisionit të vlerësimit për dhënien ose jo të titullit.

B. AUTORITETET DREJTUESE

Neni 19

Autoritetet drejtuese të UE

1. Autoritete drejtuese të UE janë :
 - a. Rektori
 - b. Dekani
 - c. Përgjegjësi i njësisë bazë/ Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit
2. Në UE ka edhe autoritete të tjera drejtuese. Ata janë :
 - a. Zëvendësrektori/ët
 - b. Kancelari.
 - c. Zëvendësdekani/ët

Neni 20

Rektori

1. Rektori është autoriteti drejtues i UE-së, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij.
2. Rektori zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e UE dhe emërohet nga Presidenti i Republikës.
3. Rektori duhet të ketë të paktën titullin “*Profesor i asociuar*” ose gradën shkencore “*Doktor*” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me një përvojë akademike në këto universitete.
4. Rektori ka mandat 4 vjeçar.
5. Rektori ka këto detyra dhe kompetenca :
 - a. Rektori drejton dhe kontrollon veprimtarinë e të gjitha strukturave të UE-së. Siguron unitetin e UE dhe është garant i autonomisë universitare brenda UE-së.
 - b. përfaqëson Universitetin e Elbasanit në marrëdhënie me të tretët,
 - c. garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit dhe të rregulloreve të brendshme të UE-së;
 - d. paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t’u shqyrtuar nga Senati akademik, Këshilli i administrimit apo Këshilli i etikës;
 - e. nënshkruan në emër të UE-së marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera homologe, nënshkruan protokollin e anëtarësimit të këtij Universiteti në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë ose të tjera, nënshkruan dokumentacionin e bashkëpunimit me organizata joqeveritare e donatorë vendas apo të huaj që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë;
 - f. cakton delegacionet dhe miraton planet e kualifikimit dhe të specializimit jashtë shtetit të mësimdhënësve, kërkuesve dhe të personelit administrativ;
 - g. është përgjegjës për mbarëvajtjen e proceseve të konkurrimit për pranimin e personelit akademik dhe joakademik dhe i miraton ato;
 - h. emëron personelin e ri mësimor – shkencor dhe atë administrativo -teknik të UE-së sipas kritereve ligjore dhe Rregullores për Zënien dhe ruajtjen e vendit të punës në UE-së. Nënshkruan kontratat e punës me personelin e brendshëm dhe të jashtëm UE-së.
 - i. lëshon diplomat e përfundimit të studimeve në cikle të ndryshme pa pasur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë.
 - j. emëron drejtorët e drejtorive, specialistët e lartë dhe personelin tjetër në UE-së, sipas kritereve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, në statut dhe në Rregulloren për Zënien dhe ruajtjen e vendit të punës në UE.

- k. miraton modelin e kontratës që nënshkruan me personelin shkencor;
 - l. miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik në bazë të udhëzimeve të MASH.
 - m. në raste të cenimit të paprekshmërisë së UE-së, Rektori ka për detyrë të denoncojë shkeljet sipas dispozitave ligjore në fuqi.
 - n. kur me veprimtarinë e tij, dekani shkel në mënyrë të përsëritur aktet ligjore e nënligjore, Statutin e UE apo rregulloret e tij, Rektori i propozon Ministrin të MASH shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për dekanin e ri.
 - o. Rektori ushtron të drejtën e marrjes së masave administrative dhe disiplinore (sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore) ndaj personelit (deri në lirim nga detyra) dhe studentëve (deri në përjashtimin nga shkolla).
6. Funkzioni i Rektorit është i papajtueshëm me funksionet e përgjegjësve të strukturave të UE-së, si dhe të kryetarit të komisionit të diplomës dhe të provimit të formimit.
7. Rektori emëron dhe shkarkon zëvendësrektorin/ët, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në senatin akademik.
8. Në mungesë Rektori delegon kompetenca zëvendësit/ve të tij.
9. Mandati i Rektorit mbaron kur:
- a. përfundon afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin;
 - d. kur pezullohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës sipas Ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pasi është ezauruar e drejta e ankimit shkarkohet nga Presidenti i Republikës.
 - e. kur largohet nga Universiteti i Elbasanit.
 - f. kur denohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.
6. Rektori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe udhëzime.
7. Përcakton fushën e veprimit të zëvendësrektorëve dhe bën ndryshimin e tyre kur e gjen të nevojshme për nevoja të institucionit në rastet dhe mënyrën e parashikuar në Rregulloren.

Neni 20

Zëvendësrektori

1. Zëvendësrektori emërohet dhe shkarkohet nga rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në senatin akademik. Ai duhet të ketë titullin “Profesor”, “Profesor i asociuar” ose dhe “Doktor”.
2. Zëvendësrektori kryen detyrat e përcaktuara në urdhrin e Rektorit, si dhe në mungesë dhe me porosi të tij, nënshkruan aktet përkatëse.
3. Zëvendësrektori ka këto detyra dhe kompetenca:
 - Ndjek, organizon dhe kontrollon veprimtarinë mësimore, edukative dhe shkencore të universitetit;
 - Ndjek hartimin edhe zbatimin e planeve e të programeve mësimore në fakultete e departamente;
 - Ndjek e kontrollon ecurinë e punës shkencore në Universitet dhe bashkëpunimin në këtë fushë me institucione kërkimore shkencore, shkolla të tjera të larta, etj;
 - Ndjek e kontrollon ecurinë e ciklit të dytë të studimeve (në momentin e funksionimit)
 - Organizon e kontrollon punën për specializimin pasuniversitar dhe kualifikimin, brenda e jashtë vendit, të personelit akademik të UE;
 - Harton projekt strukturën vjetore të procesit mësimor-shkencor dhe ia paraqet rektorit për miratim
 - Ngrehet grupe pune për probleme të veçanta të mësimin e të punës shkencore, për studime përgjithëse për zhvillimin e UE, etj dhe ia paraqet rektorit;
4. Në rastin kur ka më shumë se një zëvendësrektor fusha e kompetencës e secilit përcaktohet më vete. (Kompetencat taksative të së cilit do të përcaktohen në rregulloren e UE)

5. Marrëdhëniet e zëvendësrektorit me organet e tjera në Rektorat dhe në të gjithë Universitetin përcaktohen në rregulloren e UE-së.

Neni 21

Kancelari

1. Për përzgjedhjen dhe emërimin e kancelarit të institucionit ndiqen këto procedura
 - a) Këshilli i administrimit (KADM) miraton kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët;
 - b) Institucioni shpall publikisht vendin e punës dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për kancelar dhe shpall fillimin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve, nëse janë paraqitur së paku tri kandidatura
 - c) KADM-ja ka të drejtë të përzgjedhë, me votim të fshehtë, njërin nga tri kandidatët që ka grumbulluar më shumë pikë. Fitues shpallet kandidati që merr 2/3 e votave të anëtarëve.
 - d) KADM-ja, pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve , shpall publikisht kandidaturën fituese.
 - e) Kandidatët kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin e KADM-së, vetëm për procedurën e vendimmarrjes, brenda tre ditëve nga data e shpalljes.
 - f) KADM-ja ka të drejtë të shqyrtojë ankesat në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe u përgjigjet atyre me shkrim.
 - g) KADM-ja pas rishqyrtimit ia dërgon propozimin e vet rektorit të UE, brenda dy ditëve pune.
 - h) Rektori pas përfundimit të procesit të ankimimit, ia përcjell Ministrin të Arsimit dhe Shkencës dosjen e kandidatit për kancelar brenda 2 ditëve pune nga data e ardhjes së propozimit së bashku me vendimin e me relacionin shoqërues të KADM-së ku pasqyrohet i plotë edhe qëndrimi i pakicës, që ka votuar kundër.
 - i) Në rast se Ministri refuzon kandidaturën e propozuar e gjithë procedura përsëritet..Në rast se ministri refuzon edhe kandidaturën e propozuar herën e dytë. Ai ka të drejtë të emërojë një kancelar të komanduar, për jo më shumë se një vit.
2. Kriteret që duhet të plotësojë kandidatura për kancelar janë si vijon:
 - a) të ketë kryer arsimin e lartë ekonomik apo juridik;
 - b) të ketë se paku 5 vite eksperience pune;
 - c) të paraqesë një platformë për administrimin ekonomik financiar të Universitetit.
3. Procedura e mbledhjes së kandidaturave për kancelar të Universitetit bëhet me njoftim publik.
4. Kancelari ushtron këto kompetenca:
 - a) drejton veprimtarinë e administratës;
 - b) realizon administrimin financiar;
 - c) drejton planifikimin dhe realizimin e investimeve;
 - d) mbikëqyr të gjitha procedurat e marrjes në punë;
 - e) drejton procedurat e marrjes në punë dhe vlerësimin e ërformancës së punonjësve të administratës;
 - f) me autorizimin e rektorit, përfaqëson ose bashkëpërfaqson institucionin në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta, persona fizikë ose juridikë;
 - g) kryeson sekretariatit teknik, që mbështet veprimtarinë e këshillit të administrimit të institucionit (KADM).
 - i) mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit;
5. Ai nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ, në institucionin e arsimit të lartë.

6. Kancelari shkarkohet nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me nismën e vet, me propozimin e KADM-së ose të rektorit të institucionit.

7. Marrëdhëniet e kancelarit me organet e tjera në Rektorat dhe të Universitetit, si dhe detyrat e tjera që mund t'i delegohen përcaktohen në rregulloren e UE-së.

Neni 22

Dekani

1. Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit.
2. Dekani zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e UE dhe emërohet nga Rektori.
3. Dekani duhet të ketë të paktën titullin “*Profesor i asociuar*” ose gradën shkencore “*Doktor*” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me një përvojë akademike në këto universitete.
4. Dekani ka mandat 4 vjeçar.
5. Dekani ka këto detyra dhe kompetenca :
 - a. përgatit propozimet për probleme të ndryshme, që do t’ia paraqesë për vendimmarrje Këshillit të Fakultetit;
 - b. raporton para këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;
 - c. miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik për fakultetin që ai drejton, në bazë të udhëzimeve të Rektoratit;
 - d. ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor për fakultetin që ai drejton;
 - e. i propozon këshillit të fakultetit hapjen e qendrave kërkimore dhe të zhvillimit, të programeve të ndryshme të studimeve, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të tretët, pjesëmarrjen në projekte brenda apo jashtë vendi.
 - f. organizon dhe mbikqyr cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga departamentet apo personeli i fakultetit.
 - g. me autorizimin e Rektorit ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me fakultete e institucione homologe të vendit e të huaja;
 - h. emëron përgjegjësit e zgjedhur të departamenteve;
 - i. emëron tiullarët e grupeve mësimore e kërkimore.
 - j. drejton dhe kontrollon konkurset e pranimit të punonjësve akademikë e joakademikë në fakultetin e tij;
 - k. propozon masa administrative dhe disiplinore sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit deri në lirim nga detyra dhe studentëve deri në përjashtimin nga shkolla.
 - l. i propozon Rektorit për punësimin e personelit ndihmës-mësimor-shkencor dhe administrativ.
 - m. miraton kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave, temat e provimeve të pranimit, të provimeve të formimit dhe temat e projekteve të diplomave.
 - n. Propozon rektorit për emërim pedagogët e jashtëm që janë shpallur fitues nga komisionet e departamenteve.
6. Mandati i Dekanit mbaron kur:
 - a. përfundon afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
 - d. kur pezullohet nga Rektori sipas Ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe pasi është ezauruar e drejta e ankimit, shkarkohet nga Ministri.
 - e. kur largohet nga Universiteti i Elbasanit.

- f. kur denohet me vendim gjyqesor te formes se prere.
7. Në rastin e pezullimit të dekanit, Rektori komandon një anëtar të personelit akademik të brendshëm me kualifikimin e duhur i cili nuk do të konkurrojë në zgjedhje.
 8. Rektori thërret zgjedhjet e parakohshme për dekanin e ri në përputhje me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për periudhën 2007-2011”.
 9. Dekani në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe udhëzime.
 10. Marrëdhëniet e Dekanit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në rregulloren përkatëse të Universitetit.

Neni 23
Zv.Dekani

1. Zv/Dekani emërohet dhe shkarkohet nga Dekani pas miratimit të kandidatave të propozuara prej tij në këshillin e Fakultetit.
2. Zv/Dekani është autoriteti drejtues që merret me anën mësimore-shkencore në Fakultet dhe në mungesë të Dekanit, edhe detyra të tjera të autorizuara prej tij.
3. Zv.Dekani, për ushtrimin e funksioneve të tij ka edhe këto detyra:
 - a. Organizon e kontrollon punën mësimore shkencore në fakultet.
 - b. Ndjek zbatimin e planeve e programeve mësimorë
 - c. Organizon e kontrollon punën për specializimin pasuniversitar .
 - d. Ndjek bashkëpunimin shkencor të njësive të Fakultetit me institucionet kërkimore shkencore dhe shkollat e tjera të larta.
 - e. Ndjek punën shkencore e të procesit të doktoratave në Fakultet.
 - f. Harton projekt-planin kalendarik të procesit mësimor dhe ja paraqit dekanit për miratim.
 - g. Drejton hartimin e orarit të mësimorëve, provimeve dhe ndjek zbatimin e tyre.
 - h. Ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor nga sekretaria mësimore të cilën ka në vartësi të drejtpërdrejtë.

Neni 24

Përgjegjësi i Njësive bazë /Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit

1. Përgjegjësi i Njësive bazë/Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit është autoriteti drejtues i Departamentit/Qendrës.
2. Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik/kërkimor i brendshëm i Departamentit/Qendrës dhe emërohet nga Dekani.
3. Përgjegjësi i Departamentit duhet të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”, kurse Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit duhet të ketë të paktën titullin “**Profesor i asociuar**” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me një përvojë akademike në këto universitete.
4. Përgjegjësi i departamentit/Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit ka mandat 4 vjeçar.
5. Përgjegjësi i departamentit ka këto detyra dhe kompetenca :
 - a. përgatit propozimet për probleme të ndryshme për vendimmarrje të Departamentit;
 - b. përgjigjet para dekanit e Këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në Departament;
 - c. ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor për departamentin që ai drejton;
 - d. drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore të lëndëve që mbulon Departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre;
 - e. përgatit shpërndarjen e ngarkesës mësimore që miratohet në Departament;

- f. përgatit komisionet e provimeve të lëndëve;
 - g. organizon dhe mbikqyr cilësinë e mësimdhënies për departamentin që ai drejton;
 - h. cakton dhe drejton pjesë në komisionet për pranimin e punonjësve akademikë në departamentin e tij;
6. Përgjegjësi i Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit ka këto detyra dhe kompetenca :
- a. përgatit planin vjetor dhe planet mujore të veprimtarisë së qendrës së tij dhe i paraqet për miratim te Dekani;
 - b. ndjek zbatimin e planeve shkencore.
 - c. ngre dhe merr pjesë në komisionet për pranimin e punonjësve akademikë në Qendrën tij;
 - d. përgjigjet para dekanit e Këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të kërkimit dhe zhvillimit në Qendër;
7. Mandati i Përgjegjësit të Departamentit /Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit mbaron kur :
- përfundon afati i mandatit;
 - jep dorëheqjen;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin;
 - kur pezullohet nga Dekani sipas pikës 5, të nenit 64, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*” dhe pasi është ezauruar e drejta e ankimit, shkarkohet nga Rektori.
 - kur largohet nga Universiteti i Elbasanit.
 - kur dënohet me vendim gjyqësor te formës se prere.
8. Në rastin e pezullimit të Përgjegjësit të Departamentit/Qendrës, Dekani komandon një anëtar të personelit akademik të brendshëm me kualifikimin e duhur i cili nuk do të konkurrojë në zgjedhje.
9. Dekani thërret zgjedhjet e parakohshme për përgjegjësin e ri në përputhje me nenin 21 te ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*” dhe rregulloren “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për periudhën 2007-2011*”.
10. Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhra dhe udhëzime të miratuara nga dekanit.
11. Marrëdhëniet e Përgjegjësit të Departamentit/Qendrës së kërkimit dhe zhvillimit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, parashikohen në rregulloren përkatëse të Universitetit.

C. ORGANE TE TJERA

Neni 25

Bordi këshillimor

1. Rektori i UE konsultohet herë pas here, kur ai e çmon të nevojshme, nga një bord këshillimor.
2. Në këtë bord, ftohen nga Rektori, të marrin pjesë: kryetari i Këshillit të Qarkut Elbasan, kryetari i Bashkisë Elbasan, kryetarët e bashkive ku ka filiale UE-ja, kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatëve, kryetari i Shoqatës së Ndërtuese dhe kryetari i Shoqatës së Bankierëve.
3. Rektori ka të drejtë të thërrasë në konsultë, sipas fushave specifike, ekspertë vendas apo të huaj.
4. Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të këtij bordi apo e ekspertëve të tjerë përcaktohet me vendim të Këshillit të Administrimit në përputhje me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi.

KREU IV ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 26

Pranimet për studimet universitare

1. Studimet organizohen në këto sisteme;
 - studime me kohë të plotë;
 - studime me kohë të pjesshme;
2. Programet e studimeve propozohen nga Departamentet e Fakulteteve dhe Këshilli i Fakultetit ia paraqet për miratim Senatit Akademik.
3. Rektori shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron. para fillimit të aplikimeve për pranime në të.

Neni 27

Ciklet dhe titujt e studimeve universitare

Programet e studimeve në UE organizohen në dy cikle të njëpasnjëshme:

- a) cikli i parë;
- b) cikli i dytë;
- c) cikli i tretë

1. Studimet e ciklit të parë:

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjerë profesionesh e specialitetesh;

a. Hartimi dhe miratimi i programeve të studimit të ciklit të parë.

Në Universitetin e Elbasanit projekt-programet e studimeve të ciklit të parë konceptohen në radhë të parë nga Departamentet e Fakulteteve sipas modaliteteve të percaktuara në udhëzimet e MASH.

Projekt-programet e përgatitura nga Departamentet, përmbajnë dhe programet e të gjitha disiplinave mesimore që mund të organizohen edhe në module.

Programi i disiplinave mesimore duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Titullin e lëndës;
- Objektivat e përgjithshëm të formimit në atë lëndë;
- Objektivat specifike të formimit në atë lëndë;
- Nënndarjen në çështje të lëndës;
- Raportin e leksioneve dhe seminareve për çdo lëndë;
- Kohëzgjatjen e zhvillimit të lëndës;
- Formën e kontrollit të dijeve;
- Numrin e krediteve që propozohet t'i alokohen lëndës duke përllogaritur ngarkesën e studentit, rezultatet e procesit mësimor, aftësitë e përfutuara dhe sasinë e orëve të mësimi;
- Bibliografinë;
- Emrat e pedagogëve.

Propozimet e departamenteve, shqyrtohen dhe marrin një miratim paraprak në Këshillin e Fakultetit. Këshilli i Fakultetit shqyrton në veçanti justifikimin e departamenteve për numrin e krediteve të propozuara për çdo lëndë. Këshilli i Fakultetit mund të rikthejë propozimin për përpunim të mëtejshëm në Departamente. Orientimet e Këshillit të Fakultetit në këtë rast janë të detyrueshme për Departamentin.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit të programeve brenda Fakultetit, Këshilli i Fakultetit, përmes Dekanit, ia dërgon programin për miratim Senatit Akademik.

Senati Akademik mund ta kthejë programin e propozuar pranë Fakultetit propozues për rishikim të mëtejshëm. Orientimet e Senatit Akademik janë të detyrueshme për Fakultetin në këtë rast.

b. Kuotat e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë

Sipas akteve nenligjore të MASH UE-ja dërgon propozimet për kuota të pranimit në ciklin e parë të studimit, sipas propozimeve të bera nga fakultetet përkatëse.

Në formulimin e propozimit për kuotat e pranimit, Fakulteti propozues paraqet argumenta që lidhen me faktorët e mëposhtëm:

- misioni dhe objektivat e Fakultetit;
- programi i studimit dhe organizimi i kurrikulës
- hapësirat fizike në dispozicion të fakultetit;
- disponueshmëria e stafit pedagogjik dhe atij mbështetës duke vënë theksin tek raporti pedagog-student (referenca bëhet tek numri i propozuar i studentëve), raporti i pedagogeve të brendshëm me ata të jashtëm, niveli i kualifikimit shkencor të stafit akademik;
- disponueshmëria e mjeteve didaktike dhe burimeve të literaturës në funksion të metodave të mësimdhënies;
- tendencat në kërkesat kandidatëve për tre vitet e fundit;
- analiza e kurseve të studimit dhe diplomave në dritën e kërkesave të tregut për specialistë të profilit përkatës;
- veçoritë e programit mësimor, në veçanti raporti leksion-seminar dhe metodat e kontrollit të dijeve.

c. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë

- Çdo person që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në UE.
- Ciklin e parë të studimeve në UE mund ta ndjekin edhe studentë të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.
- Ciklin e parë të studimeve mund ta ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta (degë e dytë), kundrejt pagimit të tarifës së caktuar. (shtohet) Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.
- UE, mbi bazën e propozimeve të përgatitura nga secili fakultet, ka të drejtë të propozojë kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kriteret shqyrtohen dhe vlerësohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në këshillim me Konferencën e Rektorëve dhe Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe, mbi këtë bazë, ministri miraton, me udhëzim, kriteret dhe procedurat e pranimit në ciklin e parë të studimeve..

d. Veçoritë akademike të programit të studimeve të ciklit të parë

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh;

Kohëzgjatja dhe kreditet e programit të studimeve të ciklit të parë.

Programet e studimeve të ciklit të parë në Universitetin e Elbasanit realizohen si rregull përgjatë tre viteve akademike për një total prej 180 kreditesh.

Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë secili fakultet lëshon diplomë universitare Bachelor në fushën e arsimit të kryer. Të gjitha diplomatat e studimeve të ciklit të parë të lëshuara nga Universiteti i Elbasanit shoqërohen me suplementin e diplomës.

2. Studimet e ciklit të dytë:

- **Program studimi "Master profesional"**
- **Program studimi "Master i shkencave"**

a. Programet e studimeve "Master profesional":

Programet e studimeve "Master profesional" u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë universitare së paku "Bachelor", arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional.

Programet e studimeve “Master profesional” realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.

Studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv.

Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” janë:

1. Mesatarja e përgjithshme e studimeve të ciklit të parë
2. Përafërsia e programit të studimit

Kriteret specifike vendosen në rregulloren e fakultetit përkatës.

b. Programet e studimeve “Master i shkencave”

Programet e studimeve të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti.

Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

Studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standardet akademike të kritereve të pranimit të UE^{se}.

Kanë të drejtë të pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë “Master profesional” në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare “Master i shkencave”.

Tw drejtw pwr njohjen dhe transferimin e krediteve nga “Masteri profesional” tek “Masteri i shkencave” e ka Kwshilli i Fakultetit.

Kriteret e pranimit për standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t’u pranuar në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Janë:

1. Mesatarja e përgjithshme e studimeve të ciklit të parë
2. Përafërsia e programit të studimit

Kriteret specifike vendosen në rregulloren e fakultetit përkatës.

3. Studimet e ciklit të tretë:

1. UE krijon dhe aktivizon kurset e studimit të ciklit të tretë: Doktoraturat dhe Shkollat e Specializimit.

a- Program studimi “Doktoraturw”

b- Program studimi “Shkolla specializimi”

2. Doktoraturat sigurojnë formimin në kërkimin shkencor dhe ofrojnë kompetenca të nevojshme për të ushtruar aktivitetin e kërkimit, dhe në nivel ndërkombëtar, dhe aktivitetet profesionale të kualifikimit të lartë.

3. Shkollat e specializimit sigurojnë formimin e specialisteve në sektoret profesionale specifike në përputhje me normatën në fuqi.

4. Me përjashtim të dispozitave ligjore, Doktoraturat dhe Shkollat e Specializimit janë krijuar dhe aktivizuar me propozimin e një apo me shumë departamenteve, në përputhje me normatën nacionale dhe sipas procedurave të parashikuara nga ky Statut, dhe me anë të formave të bashkëpunimit nderuniversitar, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe janë të administruar nga këto Departamente. Mund të koordinohen nga Shkollat përkatëse.

5. Përberja dhe kompetencat e Këshillave të Doktoraturave dhe të Shkollave të Specializimit. Procedurat e përcaktimit dhe kompetencat e Koordinatorëve të Doktoraturave dhe të

Drejtoreve të Shkollave të Specializimit, si dhe modalitetet e programimit didaktik, orgaizimin dhe administrimin e po të njejteve përcaktohen në kete Statut.

Neni 28

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në UE zhvillohen me bazë vitin akademik i cili organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë në javë.
2. Kriteret e pranimit për standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

Neni

Sezonet e zhvillimit të provimeve të kursit

1. Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 3 sezone:
 - a. **sezoni i dimrit**, në përfundim të semestrit të parë, studentët do të provohen për lëndët e semestrit të parë dhe ato lëndë që kanë të mbartur nga sezoni i dimrit i vitit paraardhës.
 - b. **sezoni i verës**, në përfundim të semestrit të dytë, studentët do të provohen për lëndët e semestrit të dytë dhe në ato lëndë që kanë të mbartur nga sezoni i verës i vitit paraardhës.
 - c. **sezoni i vjeshtës**, ku studentët mund të riprovohen deri në katër lëndë në të cilat kanë rezultuar mbetës në sezonet e dimrit dhe të verës. Studenti, deri në pesë ditë para fillimit të këtij sezoni, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë SM për t'u regjistruar në provimet e atyre lëndëve që rezultojnë mbetës.
 - d. **sezone të posaçme**. Dekanatet me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe me miratim të rektoratit mund të organizojnë edhe sezone të tjera të posaçme provimesh.

Neni 29

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.
2. Pranohen për aplikim, si rregull kandidatët me diplomë të përafërt me programin e dytë në të cilin kërkojnë të studiojnë, nga të cilët përzgjidhen ata me mesatare më të lartë.
3. Kriteret e veçanta për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në rregulloret e fakulteteve.

Neni 30

Transferimet

1. UE ofron mundësi për transferime të studenteve midis programeve të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë.
2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon Fakultetit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e tij.

Neni 31

Pajisja me diplome

Me përfundimin e studimeve universitare në UE fitohen këto diploma:

1. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.
2. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare

- “Master profesional” në fushën e arsimimit e të trajnimit profesional të kryer.
3. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.
4. Diplomë e integruar e nivelit të dytë (DIND).
5. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të tretë “Doktorature” lëshohet diplomë universitare “Doktorature” në fushën e arsimimit të kryer.
6. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të tretë “Shkolla specializimi” lëshohet diplomë universitare “Shkolle specializimi” në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 32

Diploma supplement

Të gjitha diplomat e lëshuara nga UE shoqërohen me Suplementin e Diplomës i cili përmban informacionin e mëposhtëm si dhe të tjera informacione për as sa parashikohet në aktet nënligjore përkatëse:

1. INFORMACION MBI TE DIPLOMUARIN

Mbiemri;

Emri;

Datëlindja (dita/muaji/viti);

Numri i amzës i studentit;

2. INFORMACION MBI DIPLOMEN

2.1 Emri i diplomës dhe titulli që i jepet të diplomuarit;

2.2 Fusha(t) kryesore e studimeve;

2.3 Emri dhe statusi i institucionit që lëshon diplomën;

2.4 Emri dhe statusi i institucionit që administron procesin e studimeve nqs është i ndryshëm nga ai i parashikuar në 2.3;

2.5 Gjuha në të cilën janë zhvilluar studimet;

3. INFORMACION MBI CIKLIN (NIVELIN) E PROGRAMIT STUDIMOR

3.1 Cikli (niveli) i programit;

3.2 Kohëzgjatja e programit;

3.3 Kriteret e përzgjedhjes në hyrje.

4. INFORMACION MBI PERMBAJTJEN E PROGRAMIT DHE REZULTATET

4.1 Sistemi (menyra e studimit);

4.2 Veçoritë akademike të programit;

4.3 Detaje në lidhje me programin përfshi lëndët e studiuara dhe notat e kreditet e marra nga i diplomuari;

4.4 Titulli i marrë në përfundim të programit.

5. INFORMACION MBI QELLIMIN E PROGRAMIT

5.1 Mundësitë për arsimi të mëtejshëm;

5.2 Statusi profesional i të diplomuarit

Neni 33

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve

1. UE bën ekuivalentim të pjesëve ose programeve të plota studimi të marra në institucione të tjera të vendit ose të diplomave të marra në institucione të huaja sipas përcaktimeve në ligj.

2. Procedura e ekuivalentimit inicohet mbi bazen e kerkesave te paraqitura ne UE, si dhe mbi baze te regjistrimeve te realizuara per program te dyte. Kerkesat me dokumentacionin perkates i percillen fakulteteve, dekanet e te cilit krijojne nje komision Ad-Hoc, me qellim shqyrtimin e rasteve kur studenti kandidon per transferim programi studimi ne vite te ndermjetme ose kur pranohet ne program te dyte studimi.

3. Vendimet e komisionieve Ad-Hoc, nepermjet dekanit, i percillen sekretarive mesimore per te kryer veprimet perkatese, si dhe rektoratit per monitorim.

Neni 34

Vlerësimi moral për studentët

1. Studentët që, në përfundim të studimeve të plota:
 - kanë të gjitha notat dhjeta, fitojnë "**Medalje të Artë**" me certifikatën përkatëse;
 - kanë jo më pak se 80% të notave dhjeta e pjesën tjetër nënta, fitojnë Certifikatën "**Student i Shkëlqyer**".
2. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në çdo fakultet. Për studentët që fitojnë "Medalje të Artë" ose Certifikatën "Student i Shkëlqyer", ceremonia organizohet në shkallë Universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit, të profesoriatit, administratës e studentëve.

Neni 35

Norma mësimore dhe mbingarkesa

1. Mësimdhënia është detyrim më së paku 6 orë mësim në javë në auditor për të gjithë personelin akademik. Ngarkesa e plotë për personelin akademik përcaktohet me Udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.
2. Personeli akademik i njihet e drejta e pagesës së orëve të realizuara mbi normën, i sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

KREU V
KERKIMI SHKENCOR

Neni 36

Financimi i kërkimit shkencor

1. Personeli akademik apo studentët e ciklit të dytë dhe të tretë kanë të drejtë të aplikojnë pranë Rektoratit, për fonde nga buxheti i UE-së, për kërkimin shkencor.
2. Kriteret për përfitimin e financimeve për çdo vit miratohen nga Senati akademik dhe shpallen në Rektorat, fakultete dhe në faqet përkatëse të internetit.
3. Brenda muajit prill të çdo viti shpallen fituesit që përfitojnë financim të plotë apo të pjesshëm për kërkimin shkencor.
4. Me përfituesit e këtyre financimeve lidhet një kontratë e posaçme, në të cilën parashikohen të drejtat dhe detyrimet mes tyre dhe UE-së.

Neni 37

Kërkimi shkencor për të tretë

1. Kur fakultetet propozojnë të ofrojnë kërkim shkencor, shërbime, etj, për të tretë, ndiqet procedura e miratimit e parashikuar në nenin 9, pika 2, shkronja "h", e këtij statuti.
2. E njëjta procedurë ndiqet edhe kur kërkimi shkencor apo shërbimet e ndryshme ofrohen në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore apo private dhe UE duhet të kontribuojë me financim. Në raste të tilla nuk zbatohet procedura e parashikuar në nenin 28, të këtij Statuti.
3. Kur nga ofrimi i kërkimit shkencor apo shërbimeve për të tretet krijohen të ardhura, ato ndahen mes institucionit që ofron shërbimin dhe personelit të përfshirë në të, sipas parashikimeve të rregullores së brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

KREU VI
PERSONELI I UNIVERSITETIT

Neni 38

Struktura dhe organika

1. Struktura e përgjithshme e personelit e ndarë në (personel akademik, personel ndihmës mësimor –shkencor dhe personel administrativ) dhe numri i tyre për secilën pjesë përbërëse të UE-së, propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Këshilli i administrimit
2. Rektori miraton strukturën e detajuar për UE

Neni 39

Personeli akademik

1. Personeli akademik në UE ka këto të drejta:
 - a. të ushtrojë funksionin mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor në respektim të lirisë akademike;
 - b. të mos pengohet në çfarëdo forme gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
 - c. të paguhet sipas kualifikimeve shkencore, si dhe për orët shtesë në masën e lejuar nga dispozitat ligjore e nënligjore;
 - d. të përfitojë lejen vjetore të paguar;
 - e. të kryejë kualifikime shkencore, brenda apo jashtë vendit;
 - f. të kryejë detyra të tjera jashtë funksionit bazë, pa shkaktuar konflikt interesi me UE - në.
2. Personeli akademik ka këto detyrime :
 - a. të zbatojë legjislacionin për arsimin e lartë gjatë ushtrimit të detyrës dhe të respektojë rregullat e Kodit të Etikës;
 - b. të kryejë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar,
 - c. të kryejë shërbime për zhvillimin e UE dhe të kryejë detyra administrative sipas nevojave të departamentit, fakultetit apo universitetit;
 - d. të zhvillojë konsultime apo këshillime më studentët;
 - e. të përmbushë detyrën e ngarkuar, si: ngarkesën mësimore, kërkimin shkencor, etj, sipas përcaktimeve në kontratën e punës;
3. Personeli akademik në UE, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a. **Profesorë**. Në këtë kategori janë anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Ata kanë gradën shkencore “Doktor.,” dhe titujt akademikë “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus” dhe “Akademik”;
 - b. **Docentë**. Në këtë kategori janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore. Ata kanë titullin akademik “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”;
 - c. **Lektorë**. Në këtë kategori janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore. Lektorët duhet të kenë diplomë “Master i shkencave” dhe të përmbushin kriteret që përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave

Neni 40

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik me tituj i UE ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik.
2. Kërkesat për leje sabatike miratohen nga Rektori i UE pasi është marrë edhe pëlqimi i dekanit përkatës.
3. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri tremujore jashtë institucionit.
4. Midis të interesuarit dhe Rektorit të UE, nënshkruhet një kontratë e posaçme.

Neni 41

Personeli akademik i ftuar

1. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor Këshillat e fakulteteve, me propozim të departamenteve, ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie apo kërkim shkencor me kualifikimin e tyre.
3. Secili fakultet në rregulloren e tij përcakton kriteret e detajuara për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar.
4. Përgjegjësi i departamentit përkatës i paraqet dekanit të fakultetit numrin e personelit akademik për t'u ftuar dhe ngarkesën e tij mësimore.
5. Dekani i njofton Rektoratit numrin e personelit akademik të ftuar, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë ato.
6. Kontrata e punës me personelin akademik të ftuar nënshkruhet nga Rektori, në emër dhe për llogari të UE - së.

Neni 42

Personeli akademik me kontratë

1. UE ka të drejtë të punësojë me kontratë si personel akademik personalitete vendase apo të huaja, për periudha të shkurtra kohe.
2. Njësitë kryesore me propozim të njësisë bazë, të cilat përcaktojnë nevojat e tyre për staf të jashtëm, i kërkojnë senatit akademik miratimin e personelit akademik me kontratë.
3. Propozimi i njësise baze duhet të jetë i argumentuar me nevojën e fakultetit për kontributin e atij personaliteti, me kualifikimet e tij në atë fushë, si dhe me mundësinë për përballimin e shpenzimeve nga të ardhurat e UE.
4. Mund të punësohen me të njëjtën procedurë edhe studentë në procesin e kryerjes së doktoraturës dhe të përgatitjes së disertacionit për gradën shkencore "Doktor", duke i trajtuar si "Lektorë".
5. Kriteret e punësimit përcaktohen në rregullore të veçantë.
6. Kontrata e punës me këtë personel akademik nënshkruhet nga Rektori, në emër dhe për llogari të UE.

Neni 43

Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ

1. Personeli ndihmës mësimor - shkencor, si dhe personeli administrativ ka pozitën juridike që përcaktohet në rregulloren përkatëse të UE dhe në rregulloren e fakultetit përkatës.
2. Të drejtat dhe detyrimet konkrete të tyre përcaktohen në kontratën individuale të punës.

Neni 44

Procedura e punësimit

1. Marrja në punë e personelit në UE kryhet me konkurrim publik.
2. Për vendet e lira konkurrimi shpallet, duke publikuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në rregulloren përkatëse
3. Komisionet e vlerësimit të kandidaturave për vendet e lira kryesohen nga zëvendësrektori, sipas ndarjes që kryen Rektori për këtë qëllim.
4. Procedurat e konkurimit i kryen departamenti përkatës.
5. Kontratat e punës nënshkruhen nga Rektori, me cilësinë e punëdhënësit, si perfaqësues i UE-së.
6. Mënyra e zhvillimit të konkurimit, kriteret e unifikuara sipas kategorizimit të funksioneve, afatet përkatëse të komunikimit mes fakultetit dhe rektoratit, si dhe çështjet e tjera të detajuara të punësimit parashikohen në rregulloren e UE-së.

Neni 45

Masat disiplinore

1. Llojet e masave disiplinore janë:

- Tërheqje vëmendje
- Vërejtje me shkrim
- Vërejtje me paralajmerim
- Pezullim nga detyra
- Largim nga puna

2. Masat disiplinore jepen nga autoritetet drejtuese të universitetit respektivisht Rektori, Dekani, Përgjegjësi i departamentit, me përjashtim të largimit nga puna që është kompetencë vetëm e Rektorit.

3. Rastet për të cilat merret masa disiplinore përcaktohen në rregulloren e Universitetit.

Neni 46

Zgjidhja e kontratës së punës

Kontrata e punës së personelit përfundon kur:

- jep dorëheqjen;
- mbush moshën e pensionit të pleqërisë;
- vdes;
- bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar detyrën;
- dënohet me vendim penal të formës së prerë nga Gjykata, me heqje lirie;
- merr masën disiplinore të largimit nga detyra.

Neni 47

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës

1. Procedura e Pajtitimit.

1.1. Nëse lind një mosmarrëveshje gjatë apo në përfundim të detyrës mes personelit dhe punëdhënësit, secili prej tyre ka të drejtë të kërkojë fillimisht zgjidhjen e saj me pajtim, duke i paraqitur kerkese me shkrim pales tjetër brenda 10 diteve nga dita e marrjes dijeni për të drejten e pretenduar si të cenuar, apo për demin e shkaktuar.

1.2. Palet me marreveshje mund të kërkojnë ndermjetesim, duke zbatuar dispozitat ne fuqi të ligjit “Për ndermjetesimin ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve”.

2. Arbitrazhi.

2.1. Nese pala tjetër nuk pergjigjet me shkrim brenda 10 diteve, nga dita e marrjes se kerkeses per pajtim, apo nese pas seances/ave te pajtitimit, palet nuk arrijne nje zgjidhje me kompromis te mosmarreveshjes, atehere palet kane te drejte t'ia nënshtrojnë mosmarrëveshjen për shqyrtim nje forum arbitrazhi “ad-hoc”, te perbere prej tre arbitrash.

2.2. Forumi i arbitrazhit “ad-hoc” do te kete juridiksion vetem ne rast se palet kane nenshkruar paraprakisht nje marreveshje arbitrazhi.

2.3. Arbitrat per zgjidhjen e mosmarreveshjeve, qe lindin nga marredhenia e punes, caktohen nga Senati Akademik i UE-se.

2.4. Procedura e përzgjedhjes së arbitrave, kriteret e përzgjedhjes së tyre, mosmarrëveshjet që do të marrin në shqyrtim, procesi i arbitrazhit dhe afatet përkatëse, caktohen në marreveshjen e arbitrazhit te nenshkruar paraprakisht nga palet, sipas pikes 2.2.

3. Zgjidhja Gjyqesore.

Palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nëse mosmarrëveshjen e tyre nuk ia nënshtrojnë procedurës së arbitrazhit.

KREU VII **STUDENTET**

Neni 48

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

1. Cilësia e të qenit student fitohet me regjistrimin në UE dhe mbaron me diplomimin apo çregjistrimin e tij nga UE
2. Studentët gjatë ndjekjes së studimeve në UE kanë këto të drejta:
 - a. të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
 - b. të përfaqësohen në organet drejtuese të UE (Këshillat e Fakulteteve, në Këshillin e Administrimit dhe në Senatën Akademik) sipas përqindjeve të caktuara në ligj dhe në këtë Statut;
 - c. të organizohen në shoqata studentore (mbi baza jopolitike, jofetare apo joetnike), duke iu përmbytur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;
 - d. të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera;
 - e. të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit;
 - f. të përdorin të gjitha instalimet e pajisjet e UE për kryerjen e punës së tyre mësimore sipas programit mësimor dhe rregulloreve përkatëse; në biblioteka, salla kompjuterësh, mjedise sportive apo qendra të tjera në shërbim të tyre, si dhe të përfitojnë shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
 - g. Të ndjekin një program të dytë studimi (pasi kanë mbaruar programin e parë), por duke përballuar vetë koston e studimeve (me përjashtim të studentëve të shkëlqyer).
 - h. Të pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. MASH përcakton kriteret dhe procedurat e përgatitjes dhe të lëshimit të këtij dokumenti.
3. Studentët gjatë ndjekjes së studimeve në UE kanë këto detyrime :
 - a. Të respektojnë dhe zbatojnë me rigorozitet statutin e UE, të gjitha rregulloret dhe kodin e etikës, e këtij institucioni;
 - b. të marrin pjesë në veprimtaritë akademike të organizuara nga departamenti, fakulteti apo universiteti;
 - c. Të paguajnë tarifat e shkollimit dhe të shërbimeve që ofrojnë institucionet sipas afateve kohore të përcaktuara me akt administrativ nga Rektori;

Neni 49

Këshilli studentor

1. Këshilli studentor është organizim i pavarur studentor në UE, që nuk zhvillon veprimtari politike e ekonomike.
2. Këshilli studentor në UE organizohet në nivel fakulteti dhe universiteti.
3. Këshilli studentor promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UE, në strukturat mësimore-shkencore dhe të shërbimeve.
4. Këshilli studentor ka të drejtë të shprehë mendime dhe propozime për të gjitha problemet e UE.
5. Këshilli studentor zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve dhe mbështeten nga legjislacioni në fuqi.
6. Në UE, ushtrojnë veprimtarinë e tyre, Këshillat Studentorë të çdo fakulteti dhe Këshilli Studentor i UE.
7. Veprimtaria e Këshillave Studentorë bazohet në ligj, në këtë statut si dhe në aktet për organizimin dhe funksionimin e vetë këshillave.
8. Këshilli i Studentëve të UE harton statutin për funksionimin e tij. Këshillat studentorë të fakulteteve hartojnë rregulloret për funksionimin e tyre në përputhje me statutin e Këshillit Studentor.
9. Miratimi i akteve të mësipërme është kompetencë e Rektorit të UE.
10. Veprimtaria e Këshillit Studentor të UE dhe Këshillave Studentorë të fakulteteve, financohet dhe mbështetet nga buxheti i UE.

11. Përfaqësuesit studentorë janë:

- a) Përfaqësuesi studentor në Këshillin Studentor,
- b) Përfaqësuesi studentor në Këshillin e Fakultetit,
- c) Përfaqësuesi studentor në Këshillin e Administrimit,
- d) Përfaqësuesi studentor në Senatin Akademik.

Statusi i përfaqësuesit studentor parashikohet në rregulloren e UE.

KREU VIII **AUTONOMIA FINANCIARE**

Neni 50

Autonomia financiare

1. UE funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.
2. Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga UE përcaktohet në rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

Neni 51

Hartimi i buxhetit

1. Projektbuxheti i UE hartohet nga Rektorati, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse të UE.
2. Projektbuxheti i UE miratohet nga Senati akademik pasi miratohet prej Këshillit të administrimit.
3. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga Ministria e Financave.
4. Projektbuxheti i përcillet Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, i cili brenda 30 ditëve ushtron kontrollin që i takon sipas ligjit në formën e kërkesës së motivuar për rishikim.

Neni 52

Burimet e financimit

1. Burimet e financimit të UE janë :
 - b. transferta nga buxheti i shtetit
 - c. të ardhura të krijuara nga UE
 - d. burime të tjera me destinacion.
2. UE përgatit rregulloren e tij për mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e USH, në respektim të ligjeve në fuqi.

Neni 53

Kontrolli dhe auditimi

1. UE i nënshtrohet auditit financiar (të brendshëm e të jashtëm), që realizohet nga institucionet e parashikuara me ligj.
2. Rektorati përfshin në strukturën e tij një njësi të auditit të brendshëm financiar, e cila funksionon në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UE dhe në njësitë përbërëse të tij, realizohet nga auditit i brendshëm i UE dhe njësitë e auditit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
4. Rezultatet e kontrollit dhe auditit bëhen publike.

Neni 54

Niveli vertikal i autonomisë financiare

Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga UE-ja, fakultetet e deri nga departamentet përcaktohen në rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

KREU IX CEREMONITË

Neni 55

Organizimi i ceremonive

1. Në UE organizohen ceremoni të ndryshme sipas rastit. Ndër ceremonitë e përhershme që zhvillohen në UE janë :
 - a. Përvjetorët e krijimit të UE
 - b. Dorëzimi i titujve e gradëve shkencore;
 - c. Fillimi i vitit akademik
 - d. Dorëzimi i diplomave të studentëve
 - e. Dorëzimi i titullit “*Doktor Honoris Causa*”
 - f. Dorëzimi i titujve “*Profesor emeritus*” dhe “*Profesor nderi*”.
2. Në raste solemne akademike autoritetet drejtuese të UE përdorin veshje ceremoniale.
3. Organizimi dhe zhvillimi i ceremonive bëhet duke ndjekur të gjitha procedurat e protokollit të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

KREU X DISPOZITAT KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 56

Miratimi i rregulloreve

1. Brenda një muaji nga e nesërme e miratimit të këtij Statuti, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës apo brenda një muaji nga mbarimi i afatit 2-mujor për t'u shprehur Ministri, Senati akademik i UE-së miraton rregulloren e UE-së bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë Statut.
2. Rregulloret e tjera, si: rregulloret e fakulteteve, rregullorja e brendshme e administrimit, financave dhe kontabilitetit, rregullorja e Rektoratit, rregullorja e brendshme e Këshillit të Administrimit, rregullorja e etikës miratohen nga organet e përcaktuara në këtë Statut, brenda një muaji nga miratimi i rregullores së UE-së.

Neni 57

Hyrja në fuqi

1. Ky Statut hyn në fuqi me shpalljen e tij nga Rektori i UE-së, ditën e nesërme të miratimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës apo të nesërmen e mbarimit të afatit 2-mujor për t'u shprehur Ministri.
2. Nëse Ministri e kthen këtë Statut për ripunim në Senatin akademik, për vërejtje nga pikëpamja e ligjshmërisë, atëherë brenda 5 ditëve nga kthimi i Statutit, Senati Akademik mblidhet për të shqyrtuar dhe miratuar ndryshimet e propozuara me 2/3 e votave dhe statuti i riparqitet Ministrin për miratim. Nëse krijohet konflikt që nuk zgjidhet më mirëkuptim, UE rezervon të drejtën që me vendim të Senatit Akademik të kundërshtojë sipas rregullave ligjore për aktet administrative

**KRYETARI I SENATIT
Liman VAROSHI**

